

VITI I RI KINEZ NË TAJLANDË

Dita 1: Nisja nga Tirana drejt udhëtimit tonë

Udhëtimi ynë nis duke u takuar me guidën rreth orës 09:30 – 10:00 në aeroport. Nisja nga Tirana në orën 12:15. Udhëtojmë drejt Vienës, mbërrijmë në orën 13:50. Marrim fluturimin për në Bangkok në orën 20:15.

Dita 2: Mbërritja në Bangkok – Shije e parë e Tajlandës

Sapo të mbërrijmë në Bangkok rreth orës 12:20, do të na presë guida jonë dhe do të transferohemi drejt hotelit për t'u akomoduar. Në mbrëmje, do të shijojmë një darkë mirësearchjeje në një restorant tradicional tajlandez – një përzierje perfekte mes aromave pikante dhe mikpritjes së ngrohtë aziatike.

Fjetja në **Mandarin Hotel by Centre Point**.

Vaktet e përfshira : Darka

Dita 3: Bangkok – Turne i qytetit dhe tempujve të famshëm

Zgjahemi dhe konsumojmë mëngjesin në hotel, më pas fillojmë ditën duke vizituar një nga ikonat më të famshme të qytetit – Wat Traimit, ku ndodhet statuja e famshme prej ari e Budës që peshon më shumë se 5 ton! Më pas ecim nëpër rrugët plot jetë të China Town, një labirint aromash, ngjyrash dhe historish.

Vazhdojmë me vizitën në Pallatin Mbretëror, një ndër vendet më mbresëlënëse të Tajlandës dhe në tempullin Wat Phra Kaew, ku ndodhet Buda prej smeraldi – simboli më i shenjtë i vendit. Më pas, ndalojmë në Wat Pho, tempulli i Budës së shtrirë, një strukturë që të lë pa fjalë me madhështinë dhe detajet e saj artistike.

Pas drekës, do të bëjmë një udhëtim relaksues me barkë me bisht të gjatë përgjatë kanaleve të Bangkokut – të njohura si "Venecia e Lindjes". Do të vizitojmë edhe Wat Paknam Bhasicharoen, një tempull i bukur që të qetëson shpirtin dhe ofron pamje spektakolare të qytetit nga lart.

Fjetja në **Mandarin Hotel by Centre Point**.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi dhe Dreka

Dita 4: Tregu Notues Damnoen Saduak & Kanchanaburi

Zgjahemi dhe konsumojmë mëngjesin në hotel, më pas largohemi nga Bangkok dhe nisim udhëtimin drejt tregut lundrues Damnoen Saduak – një përvojë unike ku do të shohim shitës që lundrojnë mbi varka të mbushura me fruta tropikale, suvenire dhe ushqime tradicionale. Një spektakël i ngjyrave dhe kulturës autentike tajlandeze.

Më pas udhëtojmë drejt Kanchanaburit, ku do të vizitojmë Urën e Lumit Kwai dhe varrezat e luftës, vende që kujtojnë historinë tragjike të Luftës së Dytë Botërore dhe ndërtimin e Hekurudhës së Vdekjes. Vizitojmë gjithashtu muzeun Jeath, për të kuptuar më shumë mbi jetën e robërve të luftës.

Fjetja në **River Kwai Resotel**.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi dhe Dreka

Dita 5: Kanchanaburi – Erawan – Ayutthaya

Zgjohemi dhe konsumojmë mëngjesin në hotel, më pas nisim me një vizitë në Hellfire Pass, një vend me histori prekëse ku mund të ecim përgjatë një pjese të ish-Hekurudhës së Vdekjes që u ndërtua me shumë sakrifica nga vendasit.

Më pas do të shijojmë një nga mrekullitë natyrore të Tajlandës – Parku Kombëtar Erawan dhe ujëvara me 7 nivele, që është një parajsë për të gjithë adhuruesit e natyrës. Ndalesat për të notuar nëpër pishinat natyrore janë të pashmangshme!

Pas drekës, do të udhëtojmë drejt qytetit historik Ayutthaya, një ish-kryeqytet mbretëror i mbushur me rrënoja tempujsh dhe mister.

Fjetja në **Centara Ayutthaya Hotel**.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi dhe Dreka

Dita 6: Ayutthaya – Tempuj dhe histori e gjallë – Rikthim në Bangkok

Zgjohemi dhe konsumojmë mëngjesin në hotel, më pas do të eksplorojmë Parkun Historik të Ayutthaya, pjesë e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Do të shëtisim mes rrënojave të katër tempujve më të rëndësishëm:

Wat Mahathat, ku rrënjët e një peme kanë përqafuar kokën e një statuje Buda, një pamje magjepsëse dhe simbolike.

Wat Yai Chai Mongkol, i njohur për statujat e shumta të Budës dhe atmosferën shpirtërore.

Wat Chai Wattanaram, tempull me arkitekturë simetrike që pasqyron fuqinë e Mbretërisë së Ayutthaya.

Wat Phra Sri Sanphet, një nga tempujt më të rëndësishëm mbretërorë.

Pas këtij udhëtimi nëpër histori, rikthehemi në Bangkok për të kaluar natën.

Fjetja në **Mandarin Hotel by Centre Point**.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi dhe Dreka

Dita 7: Pushim dhe mbrëmje magjike mbi lumin Chao Phraya

Zgjohemi dhe konsumojmë mëngjesin në hotel, këtë ditë do ta kemi të lirë për të pushuar, për të bërë shopping në qendrat tregtare ose për të shijuar Bangkokun sipas dëshirës.

Në mbrëmje, do të mbyllim këtë aventurë me një darkë të paharrueshme në një kroçierë mbi lumin Chao Phraya, nën tingujt e muzikës live dhe pamjet e Bangkokut të ndriçuar. Një fund magjik për një udhëtim të mrekullueshëm.

Fjetja në **Mandarin Hotel by Centre Point**.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi dhe Dreka

Dita 8: Lamtumirë Tajlandë!

Pas mëngjesit, bëjmë check-out në mesditë dhe do të transferohemi në aeroport për të marrë fluturimin drejt shtëpisë, me zemrën plot kujtime nga Tajlanda.

DETAJE RRETH FLUTURIMIT :

Fluturimi Shqiperi – Indi 16 Nëntor 2025

Tirane (TIA) – Varshave (WAW) : 12:55 – 15:00

Varshave (WAW) – Delhi (DEL) : 17:20 – 05:10 (15 Mars)

Fluturimi Delhi – Shqiperi 22 Nëntor 2025

Delhi (DEL) – Varshave (WAW) : 07:00 – 11:20

Varshave (WAW) – Tirane (TIA) : 14:45 – 16:55

DETAJET E TURIT

Përfshihen në çmim :

- Fluturimi V/A Tirane – Bangkok – Tirane
- 6 netë akomodim në dhomë 2-she në hotele 4* (4 netë në Bangkok, 1 natë në Kanchaburi, 1 natë në Ayutthaya)
- Mëngjeset dhe Drekat + 1 Darkë Speciale
- Shëtitje me varkë në tregun e lundrueshëm Damnoen Saduak (Bangkok)
- Xhiro me Tuk Tuk në Bangkok
- Transporti me autobus komod sipas itinerarit të përshkruar në program
- Guidë Lokale në Anglisht
- Shoqerues Shqiptar nga agjensia
- Biletat e hyrjeve në monumente dhe muze sipas programit
- Të gjitha taksat e transportit dhe hoteleve

Nuk përfshihen në çmim :

- Darkat
- Shpenzime personale
- Cdo aktivitet që nuk përmendet në rubriken “përfshihet”
- Bakshishe për shoferin dhe guidën (5eur / person / ditë)